



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10744 Prot.

Roskovec, më 29.12 2025

**VENDIM**

NR 67 .DATË 24.12 .2025

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN NËNTOR 2025”***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 27.11.2025, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Nëntor 2025.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10025/1 Prot.

Roskovec, më 27.11.2025

**Procesverbal Nr.11**

*-I mbajtur sot, datë 27.11.2025, ora 13<sup>00</sup>, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Tetor 2025.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Tetor 2025.
5. Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve, të punës dhe të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2026.
6. Për miratimin e listës së përfituesve për individë / familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët.
7. Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026.
8. Për miratimin e procedurës së binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec Shqipëri dhe Komunës së Ururit Itali.
9. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13<sup>10</sup>

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, P.Toro, A.Pelo, S.Bibo Qamili, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, Rr.Hazizi, F.Hoxha, Zh.Metushi, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, A.Hoxha, V.Çepele,

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ardhurave Vendore S.Çepele, P/Shërbimit Social E.Kola, Komisioni i Strehimit, SP/Integritit European U.Blido.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 12 këshilltarë. Kryetari –përshëndetje të gjithëve, faleminderit të nderuar këshilltar që jeni bërë pjesë e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Roskovec, mbledhje e datës 27.11.2025. Ashtu siç jeni njoftuar paraprakisht dhe jeni njohur me materjalet, projekt-vendimet që do të shqyrtohen në këtë

mbledhje që në datën 19.11.2025, përsa kohë kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e kësaj mbledhje është i pranishëm, ne kemi të pranishëm në sallë 12 nga 21 antarët e Këshillit, unë e deklaroj këto mbledhje të hapur. Në rendin e ditës me të cilin jeni njohur paraprakisht nuk kemi asnjë ndryshim. Për procedurë kërkon dikush fjalën sa i takon rendit të ditës? Atëherë meqënëse nuk kemi asnjë diskutim për rendin e ditës, ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni rendin e ditës së kësaj mbledhje.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari -kush është pro me rendin e ditës të njoftuar paraprakisht? Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet unanimit me 12 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Tetor 2025.

Kryetari-vazhdojmë të nderuar këshilltar me një informacion të shkurtër mbi vendimet e marra në mbledhjen e muajit Tetor 2025. Arlinda të lutem një relacion shumë të shkurtër për këshilltarët. Sekretarja e Këshillit- përshëndetje të nderuar këshilltar. Ju bej me dije se në mbledhjen e fundit të muajit Tetor, ju keni miratuar 4 vendime gjithësej, nga të cilat vetëm 1 prej tyre ishte vendim me karakter normativ, të cilin ne e kemi dërguar në Prefekturë për verifikim ligjor. Vendimi normativ është miratuar nga Prefektura. Pastaj ju e dini se çdo muaj është e përsëritshme, këto vendime pas hyrjes në fuqi shpërndahen në zyrat përkatëse për zbatime të mëtejshme ligjore.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- gjithashtu të nderuar këshilltar me materialet e shpërndara tek ju në datën 19, jeni njohur me procesverbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, të cilën në qoftë se nuk ka askush vërejtje sa i takon përmbajtjes së këtij procesverbali, ju ftoj ta votojmë procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimit me 12 vota pro. Kryetari-me të gjitha votat pro të këshilltarëve të pranishëm në këtë mbledhje, miratohet procesverbali i mbledhjes së muajit Tetor të Këshillit të Bashkisë Roskovec.

4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Tetor 2025.

Kryetari-presim pak minuta sa të kemi të pranishme në sallë specialisten që do ta relatojë këtë projekt-vendim. Ndërkohë ju pyes sepse kemi bërë një marrëveshje, ka nevojë që të dëgjojmë relacionin në lidhje me këtë projekt-vendim apo i qëndrojmë asaj që kemi diskutuar? Fredi-në qoftë se ka ndonjë ndryshim? Sp.Enkeleda-nuk ka ndryshim. Kryetari-atëherë për pyetje ose për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim e kërkon dikush fjalën? Fredi-thjesht kisha një pyetje. Personat unë e di se nuk duhet lejuar pafundësisht, deri në 6 muaj dhe ndërrohen ata, apo ska problem? Se shikoj njerëz që janë pafund aty. Enkeleda-ajo varet nga kushtet që ka gjithsecili, ka persona të cilët jemi të detyruar që ti lejojmë dhe më shumë se 6 muaj sepse nuk kanë të ardhura të tjera si të sigurojnë ushqimet. Fredi-është tjetër gjë ajo, absolutisht, pra nuk është automatikisht jo më shumë se 6 muaj? Enkeleda-jo nuk është automatikisht. Kryetari-mirë faleminderit, tjetër kush?

Atëherë për sa kohë nga salla nuk kam kërkesë për pyetje, për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Tetor 2025”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimit me 12 vota pro. Kryetari-me të gjithë votat pro të këshilltarëve të pranishëm miratohet ky projekt-vendim, faleminderit për votimin.

5.Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve,të punës dhe të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2026.

Kryetari-siç tashmë e kemi përvojën, çdo vit dhe Këshilli bën një plan të aktiviteteve të veta vjetore, që besoj se Arlinda do na thojë përmbledhtas dy fjalë, apo të vazhdojë unë Arlinda? Sekretarja-po, mund të vazhdosh Kryetar. Kryetari-në materialin me të cilin ju jeni njohur paraprakisht, keni të shënuar gjithë aktivitetet e parashikuara nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2026. Nuk kemi pasur nga ana e administratës ndonjë lloj kërkesë paraprake për procedurat të cilat kërkojnë dëgjesa publike, përveç procedurave standarte siç është Paketa Fiskale apo siç është Projekt-Buxheti. Në këtë mënyrë nuk kemi parashikuar dëgjesa publike më shumë sesa standarti që keni pasur dhe vitin tjetër. Ky është plani i gjithë aktiviteteve që çdo këshilltar duhet të eci mbi këtë bazë dhe të bëjë planifikimet e veta, sepse pjesëmarrja e të gjithë neve në të gjithë aktivitetet që janë parashikuar këtu është një detyrim ligjor, moral por do të ndikojë shumë dhe në mbarëvajtjen e të gjithë punës së këtij Këshilli. Kërkon dikush fjalën sa i takon këtij projekt-vendimi për pyetje apo për diskutim? Nuk ka. Kryetari-atëherë pyetje dhe diskutime nga këshilltarët nuk kemi asnjë të tillë, ndaj unë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e planit vjetor të aktiviteteve,të punës dhe të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimit me 12 vota pro. Kryetari-me të gjithë votat pro miratohet ky projekt-vendim, ju falenderoj për votimin.

6.Për miratimin e listës së përfituesve për individë / familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët.

Kryetari-këtë projekt-vendim do ta relatoni ju z.Nënkryetar apo do vij specialisti? Nënkryetari z.Maksi-po. Kryetari-atëherë fjalën për të bërë një relacion përmbledhtas të këtij projekt-vendimi e ka z.Maksi. Maksi-të nderuar këshilltar, në emër të komisionit për vlerësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e banesave sociale të Entit të Banesave, në bazë të vendimit të Këshillit të Bashkisë të vitit 2025, 04.10.2025 për kriteret, komisioni i ngritur me urdhër të Kryetares së Bashkisë kanë mbledhur të gjitha kërkesat për strehim dhe janë gjithësej 112 kërkesa nga qytetar të ndryshëm, në vite të ndryshme duke filluar nga 2022 deri në 2025, dhe ky komision pasi vlerësoi të gjitha kërkesat të cilat ishin të ligjshme apo të paligjshme, është mbledhur disa herë në fazën e parë, të dytë dhe të tretë për të bërë një vlerësim të të gjitha pikëve sipas kriterëve të përcaktuar nga ana juaj si Këshill Bashkie. Janë zbatuar të gjitha kriteret dhe pasi janë verifikuar të 112 kërkesat, 76 prej tyre kanë qënë nga ato që plotësonin të gjitha kriteret 76 prej tyre, nga 76 sipas Entit të Banesave dhe numrit të banesave të ndërtuara, janë 29 banesa që do të jetë dhe lista përfituese, dhe pas 29 kërkesave duhej një listë prej 20 në listë pritje. Ne pasi kemi në bazë të pikëve, për kushtet sociale, kushtet ekonomike dhe kushtet e tjera të strehimit, kemi përcaktuar dhe dy lista të tjera, një

listë që kanë tejkaluar të ardhurat me 7 persona dhe një listë tjetër me 8 persona që në bazë të pikëzimit mund të ishin fitues por të drejtën e banimit apo kushtet ekonomike e kanë pasur gjatë viteve 24-25. Të tëra këto lista ju i keni para, kështu që nuk ka nevojë besoj ti lexojmë. Komisioni ka dal dhe në terren, ka parë dhe kushtet në të cilat banojnë të gjitha familjet, ka parë të gjithë dokumentacionin ligjor dhe përpara jush sot vijmë me një listë, me 29 familjar që përfitojnë me vendim unanim, komisioni ka qënë unanim në të gjithë vendimmarrjen. Njëkohësisht vijmë me listën e dytë me 7 persona, të cilën përsëri e keni përpara që i kalojnë të ardhurat, janë me të ardhura më shumë se niveli i jetesës, sipas të ardhurave të vlerësimit që bën Instati në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe për Bashkinë e Roskovecit, janë mbi 120% të ardhurat dhe lista e tretë është ata që përfitojnë më pak se pikët e nevojshme pas numrit 29 ose ajo vija e kuqe që është lista e tretë. Të dyja këto lista si lista me 7 dhe ajo me 8 hyjnë në listën e përfituesve rezervë, që do të jenë rezervë në Entin e Banesave pasi Enti i Banesave e ka kompetencën dhe autoritetin e plotë të lidhi kontratat me familjarët, në bazë të nivelit të pagesës që do të ketë paraprak një 10% dhe pastaj për çdo muaj për 15 vite me radhë. Kështu që këto janë kriteret që do ti zbatoj Enti i Banesave me përfituesit. Unë do ju thoja atë që ju kam thënë njëherë këtu në mbledhje të Këshillit si Kryetar i Komisionit dhe Nënkyetar Bashkie, është punuar me përgjegjësi maksimale për të ardhur përpara Këshillit dhe qytetarëve të cilëve do tu afishohet kjo listë, me moralin më të lartë që ata që e meritojnë janë në listën e 29-çes. Këtë ua them sinqerisht dhe mbaj përgjegjësi dhe në emër të gjithë komisionit të cilët kanë paraqitur këtë listë përpara jush. Në qoftë se ju doni ti lexojmë emrat, besoj se i keni përpara. Këshilltarët-i kemi përpara. Maksi-në qoftë se doni sqarime dhe pyetje të tjera, unë jam gati për tju përgjigjur së bashku me komisionin të cilët i kemi aty. Kryetari-faleminderit z.Maksi. Për pyetje sa i takon këtij projekt-vendimi? Fredi-a ka ndërtesa të tjera sepse Kryetarja e Bashkisë tha do jetë dhe një pallat tjetër e para, dhe a mund të futen në qoftë se do jetë pallat tjetër, personat e skualifikuar mund të futen? Maksi-sot jemi para një fakti që 29 banesa, apartamente janë në dispozicion të Këshillit të Bashkisë për të vendosur listën nga 1 deri në 29. Jemi në tentativë me Entin Kombëtar të Banesave, kemi shpronësuar dhe tokën atje për ndërtimin e një pallati, po me të njëjtën sipërfaqe të truallit dhe të kërkojmë të njëjtin numër apartamentesh, rreth 30 apartamente. Lista e dytë në pritje varet nga ata që plotësojnë listën e parë dhe në listën e dytë besoj se në qoftë se ju miratoni sot 29-çen dhe 15 të tjerët që janë në listën e pritjes, këta 15 të tjerët e kanë prioritetin e parë përpara se te vazhdojnë pastaj kërkesat e tjera. Njëkohësisht ne nga sot në qoftë se do të hapim aplikimin për pallatin e dytë, kanë të drejtë të aplikojnë dhe të tjerë, jo vetëm këta që janë në listën e tanishme, jo këta 76 vetëm por mund të aplikojnë dhe të tjerët që kanë nevojë për strehim. Lexi-nga analiza që u është bërë aplikantëve, tek 8 aplikantë që sipas sistemit të pikëzimit nuk marrin pikë por janë tek lista e të kualifikuarëve, ve re një aplikant i cili ka banesë por paraqet rrezik shëmbje, si do veprohet me këtë person? Maksi-në atë listë ne jemi menduar që lista që quhet lista e tretë pak a shumë për tu miratuar në Këshillin e Bashkisë, kemi futur dhe gjithë personat e Mbërsit të cilët kanë rrezik shëmbje të banesave por nuk kanë kushte ekonomike për të vajtur pranë Entit të Banesave, nuk kanë kushtet ekonomike për të lidhur kontratë sepse nuk kanë të ardhura, pa të ardhura Enti i Banesave është ekonomi tregu, thotë në qoftë se ske të ardhura nuk të lidh dot kontratë, kështu që ndaj i kemi lënë në këtë listë, jo se meritonin pikë, kishin pikë por nuk plotësojnë kriterin ekonomik, pra nuk kanë të ardhura. I jemi drejtuar Këshillit, emergjencave civile që ato 8 banesa atje, kemi hapur shumë thirrje për të na dhënë fonde me qëllim që ti sistemojmë në vend tjetër, po ti sistemojmë pa pagesë, janë këta Brahushajt që janë sot. Kryetari-faleminderit z.Maksi, dikush tjetër e kërkon fjalën?

Ndërkohë a mund të kemi një saktësim z.Maksi sa i takon procesverbalit që na keni paraqitur, mund ti referohesh? Maksi-po, saktësim? Kryetari-po tek data. Leksi-te data, te ora janë bosh. Maksi-tani për data e këto plotësisht dakort, përpara datës 20 e..përpara mbledhjes së Këshillit për arsye se pasi kërkonin disa herë kërkesat, pasi kërkonin disa herë që vajtëm dhe në vend për të verifikuar se kush janë kushtet e banimit të gjitha kërkesat, këto datat kuptohet që është procesverbal, nuk është se është për miratim procesverbali në Këshill, në Këshill miratohet relacioni dhe listat. Është pa plotësuar keni të drejtë, plotësohet se të gjitha datat janë me protokoll të rregullt, jemi mbledhur disa herë nuk jemi mbledhur 1 herë. Kryetari-atëherë për diskutim? Po fjalën për diskutim e ka z.Leksi. Leksi-meqënëse jemi në pikën për miratimin e listës së përfituesve për familjet që fitojnë banesa me kosto të ulët, unë personalisht si anëtar i Këshillit nuk kam ndonjë ngarkesë të madhe sepse nuk kam ndonjë të njohur, ndonjë diçka kështu që të shprehem pro ose kundër, por dua të përshëndes dhe të komplimentojë punën e komisionit, sepse në shikimin e parë që i kam bërë dhe shikimit përfundimtar, besoj se të gjithë ata persona që kanë përfituar janë tamam persona në nevojë, me kushte sociale-ekonomike të dobët, por që kanë plotësuar dhe kriteret e përfitimit të banesës sociale. Kështu që besoj se më mbetet të them që ata ti gëzojnë ato banesa, dhe keqardhje për ata që nuk kanë marr sepse dhe lista që janë dhe në pritje dhe lista tjetër që është që nuk kanë përfituar, besoj se edhe ata me kushte jo të favorshme ekonomike janë për të ngritur një banesë ose për të ndërtuar një banesë. Prandaj e thashë edhe njëherë puna që ka bërë komisioni është për tu lavdëruar sepse edhe unë po të isha, natyrisht që jam një person i zgjedhur nga Këshilli, do isha i fokusuar te 1 emër ose 2 emra, kurse këta kanë bërë një punë të lavdërueshme për pjesën e zgjedhjeve të personave që hyjnë në familje, ti gëzojnë ata familje në rast se ne e kalojmë këtë projekt-vendim dhe keqardhje për ata që nuk ashtu, megjithatë në qoftë se ka banesë që mund të ndërtohet përsëri besoj se dhe mund të realizohet. Përderisa kemi 29 hyrje me 76 kërkesa që janë me dokumentacion të plotë, do të thotë që do ketë dhe të pakënaqur por besoj se puna është bërë e lavdërueshme. Maksi-faleminderit. Kryetari-faleminderit z.Leksi, dikush tjetër për diskutim e kërkon fjalën? Fredi-unë nuk i njoh personalisht asnjërin, veçanërisht një grua është nga fshati Ngjeqar ka qënë e martuar, nuk paragjykojë asnjë njeri nga këta, ata janë hallexhinj deri sa kanë vajtur atje, këto sjanë pa lekë, janë me kosto të ulët, por vet unë kam kërkuar në mbledhjen kur u bë për pikëzimin e tyre dhe kam kërkuar që një anëtar i Këshillit Bashkiak ose dy, një nga ne dhe dy nga grupi tjetër grupi i partisë socialiste, të ishim atje për hir të transparencës. Vet këmbngulja e Bashkisë ishte që mos të merrnim pjesë, justifikime nga më të ndryshmet dhe pa patur asnjë gjë me ata personat që kanë përfituar, por unë dua të tregoj që vota ime këtë radhë do të jetë abstenim për arsyen e vetme që nuk pranuat që të ishte një anëtar Këshilli ose dy, ose tre. Unë thashë çoni sa të doni po vetëm nga ne si grup të kishim një, dhe kjo më bën të dyshojë, pa parë asnjë se snjoh thashë me përjashtim të një, dhe kështu që unë shpjegova votën time që jam abstenim, faleminderit. Maksi-mbledhjet e komisionit janë bërë të gjitha të hapura, vendimi i Këshillit ishte i tillë që komisioni prej 7 vetash do të kishte kompetencat dhe autoritetin e plotë ligjor për të bërë atë punë, dhe mbledhjet e komisionit janë bërë disa mbledhje, nuk është bërë një por janë bërë disa mbledhje deri sa të vinim në këtë produkt, besoj se i frytshëm për qytetarët dhe për Këshillin, faleminderit. Kryetari-atëherë nuk kemi kërkesë tjetër për diskutime, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e listës së përfituesve për individë / familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 11 vota pro, 1 votë abstenim F.Feleqi. Kryetari-miratohet ky projekt-vendim. Gjithë qytetarët që janë në listën fituese unë ju uroj ta gëzojnë

shtëpinë e re dhe të kenë mbarësi në këtë inisiativë të re që kanë marr. Ju falenderoj për votimin të gjithë ju këshilltarëve. Sekretarja-kemi dhe një qytetar të pranishëm që interesohej për këtë pikë. Kryetari-ka regjistruar kërkesë? Sekretarja-jo, është thjeshtë për të dëgjuar. Kryetari-ok, kjo u votua dhe do publikohet vendimi.

## 7.Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026.

Dr.Ardhurave Vendore Selmani-të nderuar këshilltar, u paraqesim për miratim paketën fiskale për vitin 2026 për Bashkinë Roskovec, bazuar në ligjet përkatëse. Sa i përketë kësaj pakete ne kemi bërë dhe dëgjesat publike së bashku dhe me dëgjesat për buxhetin e vitit 2026, është i dokumentuar pa dyshim. Sa i takon ndryshimeve që ne kemi paraqitur, shumica e këtyre taksave dhe tarifave nuk ndryshojnë, janë ato të miratuara për vitin 2025 dhe këto ndryshime konsistojnë : në tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave kemi bërë ndryshimin në lidhje me subjekte shërbimi me TVSH, e cila ka qënë 30 në Njësitë Administrative, është bërë 38. Tregtim karburantesh në rrugë nacionale nga 90 që ka qënë në qytet është bërë 80 mijë, dhe Njësitë nga 90 po ashtu 80 mijë. Në lidhje me tregtim karburantesh nëpër fshatra është bërë nga 45 mijë në 50 mijë. Tarifa të reja për lloj të këtyre bizneseve është bërë shtesë në lidhje me biznese që ushtrojnë aktivitete në lidhje me makina me qera që nivelet i keni aty, pra këto janë shtesë që nuk kanë qënë, lavazho, pika e tregtimit të gazit biznes fizik, pika e tregtimit të gazit biznes juridik dhe subjekte për transport mallrash ndërkombëtar. Këto janë shtesë të tarifave që nuk kanë qënë në paketën e vitit 2025. Këtu do të cilësojë sepse tek relacioni është bërë një lapsus, te relacioni duhet që tek pika 3 e tregtimit të gazit biznes fizik, duhet që dhe në Njësitë Administrative është 30 mijë ashtu sikurse është dhe tek projekt-vendimi i paketës fiskale. Po ashtu dhe pika e tregtimit të gazit biznes juridik është 50 mijë, ashtu sikurse është dhe tek paketa fiskale. Tarifa për parkim të rezervuar, është bërë dhe këtu rritje e tarifave të cilat i keni në tabelën përkatëse, sa ka qënë në vitin 2025 dhe sa mendohet që të jetë në vitin fiskal 2026. Janë bërë shtesë që nuk kanë qënë në vitin 2025, pasi tani është konsoliduar dhe funksionon Muzeu i qytetit, në lidhje me tarifat për bileta individuale, bileta në grup, bileta familjare, bileta studenti në vlerën që ju kemi paraqitur. Tarifa për kundravajtje administrative, ka qënë 10 mijë lekë për ndotje mjedisi nga kafshët dhe shpendët dhe është bërë tarifë për ndotje mjedisi nga kafshët dhe shpendët nga 5 mijë deri në 20 mijë. Po ta shikosh, shikohet një rritje po faktikisht nuk është rritje por një shkallëzim sipas numrit të shpendëve që mund të ketë secili, pra nuk mund ti vendosësh 100 mijë lekë një fermeri që ka 10 shpendë, prandaj kemi ulur atë bazën. Gjithashtu shtesë është bërë në lidhje me shkeljet e kryera, sidomos me mbjelljen e pemëve në hapsirat publike pa miratimin e Bashkisë 20 mijë lekë dhe tregtim nga shitës ambulant jashtë zonës të përcaktuar nga Bashkia është 2 mijë lekë. Këto janë në formën e gjobave sipas dënimit. Jam i hapur që tju përgjigjem pyetjeve dhe sqarimeve që ju mund të kërkonit në lidhje me këtë paketë fiskale. Kryetari- përpara sesa tju jap fjalën për pyetje këshilltarëve, do doja të bëja unë një saktësim që duhej ta kishit bërë ju. Tek ndryshimet që keni bërë tek tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, kemi të shënuar dy herë tregtim karburantesh në rrugë nacionale, tek relacioni që na keni shpërndarë. Selmani-është tregtim karburantesh në rrugë nacionale dhe tregtim karburantesh nëpër fshatra. Kryetari-jo e ke aty ku bëhet, e keni shënuar dy herë. Selmani-jo është tregtim karburantesh nëpër fshatra. Kryetari-po pra në rrugë dytësore, duhet ta saktësojmë këtë sepse e keni shënuar dy herë. Selmani-ose në rrugë dytësore po. Kryetari-atëherë ta shënojmë, është në rrugë dytësore. Po kush e kërkon fjalën? Po z.Maksi. Maksi-të nderuar këshilltar, kjo është

paketa fiskale për vitin 2026 që Selmani i përmendi ato ndryshimet. Unë dua të them që si Ekzekutiv jemi përpara Këshillit të Bashkisë pa ndryshuar asnjë lloj takse dhe tarife vendore për familjet. Ato që janë shtuar apo pakësuar për bizneset qoftë edhe për kundravajtjet, që janë pakësuar nga 20 mijë lekë të reja që ka qënë, është bërë 20 mijë lekë të vjetra kundravajtje administrative për tregëtimin në vende të ndryshme, dhe vendosja e taksës së pularive, janë dy kërkesa për pulari në territorin e Bashkisë së Roskovecit, detyrimisht që këto krijojnë dhe mbetje urbane ndaj dhe taksat duhet të jenë në bazë të numrit të krerëve sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave. Taksat që kanë ngrënë diskutim në dëgjuesat publike që janë bërë në të gjitha fshatrat, ka qënë ajo e parkimit të makinave 24 orëshe për bizneset. Ka qënë 30 lekë për 24 orë është bërë 80 lekë për 24 orë, pra 80 lekë për 24 orë në 365 ditë të vitit që mban një parkim të rezervuar një biznes, do të paguaj vetëm 30 mijë lekë të reja nga 365 ditë, sa i bie 80 lekë në ditë. Për të parkuar një makinë në ambjente të tjera është shumë herë më i lartë, 1 orë mund të jetë 2, mund të jetë 3, mund të jetë dhe 4 mijë lekë të vjetra, ndërsa ne themi 24 orë është 80 lekë. Është shtuar tej mase biznese që kërkojnë aktivitet të tillë dhe duke pasur parasysh dhe kërkesat po edhe pagesën e ulët që ka qënë, themi që të rritet kjo pagesë. Nuk është problemi për ti rënë në qafë biznesit por është dhe për të siguruar të ardhura në këto vende që janë shumë të frekuentueshme dhe nga qytetarët për të pirë një kafe apo për të bërë diçka tjetër, që të vejë të parkojë makinën nuk e parkon dot sepse është me vija të verdha, është i bllokuar për 300 lekë në ditë, dhe nga qytetarët ka pasur edhe ankesa por ka pasur edhe sugjerime shumë të mira, vlerësime që thonë po për 30 lekë e paguaj edhe unë se do vete të pijë kafën atje dhe e le makinën përpara lokalit. Mbase nuk është arsyetim por e thashë edhe njëherë që ka qënë një nga tarifat që ka ngrënë shumë pak debat, por në përgjithësi kanë qënë vlerësime dhe për këtë taksë. Nuk ka pasur biznese që të jenë ankuar përkundrazi e kërkojnë që të paguhet. Dhe me të fundit duke u falenderuar për dëgjuesën në emër të Selmanit, Selmani ka kaluar Drejtor i taksave dhe tarifave vendore, kërkojë nga ana juaj miratimin e kësaj pakete fiskale me qëllim që ti hapim rrugë miratimit të buxhetit në muajin Dhjetor, që do e sjellim në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Bashkisë. Kryetari-faleminderit z.Maksi, për pyetje e kërkon dikush fjalën? Për diskutime në lidhje me këtë projekt-vendim? Fredi-për pyetje. Kryetari-po fjala është për z.Fredi. Fredi-a keni një shifër, sa është shifra e papaguar e taksës së tokës ndër vite në shkallë Bashkie? E dyta, a është shkelje e ligjit mbledhja e tarifës për aty ku nuk shërbehet? Tre, vitin e kaluar vendosëm një tarifë për mbledhjen e mbeturinave në një fushë, konservim se ça quhej ajo nuk e di, kundrejt një tarife. Ata që e sillnin vet nuk paguanë, ata që venë ua merrnim..si ka ndikuar, a janë mbledhur a skanë mbledhur, a ka pasur penalizime për ata që i kanë hedhur rrugëve, kanaleve sepse është dhe një arsye edhe e përmbytjeve, se unë kam bredhur në territor dhe duhet të ketë edhe penalizim ai që i hedh atje, e kupton? Tjetër, a janë përjashtuar prapë nga taksa e tokës personat që janë anëtarë të Odës së Fermerëve? A keni menduar për uljen e taksës së tokës sepse zona jonë ka qënë, sidomos ky vit ka qënë një thatësi e tejzgjatur që edhe prodhimet kanë qënë, edhe prodhimi i ullirit edhe prodhimet e perimeve, edhe prodhimet në fushë në nivele shumë të ulta nga ndikimi i thatësisë së tejzgjatur. A keni menduar për ulje 30% ,të ulët një përqindje, 30% se e kisha si propozim. Keni menduar ndonjëherë ju sepse bëhet një studim për ndikimin nga ngrohja globale, nga thatësitat, nga fatkeqësi natyrore por në fund të fundit duhet të reagojmë, këto kisha. Selmani-jo vetëm për taksën e tokës por për çdo taksë tjetër dhe për çdo tarifë tjetër ka shifër të saktësuar për çdo person dhe individ. Fredi-jo se diskutojë atë, sa është mbledhur të ma japësh sot? Elmazi-sa është mbledhur thotë ai dhe sa përqind është pa mbledhur. Selmani-i kam por këtu nuk jemi të përgatitur për këtë gjë se janë

tarifat, nëse do duhet pastaj do të shkoj, ose në mbledhjen tjetër ose të vete tani të marr të dhënat. Maksi- Selman në 2024 ti e ke taksën sesa është mbledhur. Selmani-tani ai do shifër, shifrën unë nuk do ta jap kështu.. Fredi-jo ky vit i përfshirë se ky ska mbaruar akoma. Selmani-i gjithë pra, i apdëtuar nga koha që kanë filluar taksat. Maksi-megjithatë në analizën e 6-mujorit që është bërë nga Ekzekutivi, janë paraqitur të gjitha të dhënat që ajo goca që ishte në drejtorinë e taksave dhe tatimeve, Selmani ndaj është i ri, i ka paraqitur dhe jemi tek 80% i pagesave të taksës së tokës në të gjitha ato vitet, pak a shumë 78-82% 6-mujori i parë. Kuptohet që të ardhurat ishin më të larta, në nivele të larta për 6-mujorin rreth 95% për 6-mujorin, ndërsa kur shtohet i gjithë viti do arrijmë përsëri tek 80%-çi, nuk e kalojmë 80% që të jemi korrekt me njëri-tjetrin. Aty ku nuk shërbehet pse duhet të paguhet? Fredi-jo a është ligjore, se e di që e keni mbledhur, kam fakte që e keni mbledhur, a është ligjore apo jo? Maksi-për kë, për kanalet e treta? Fredi-po për shumë gjëra. Maksi-për shumë gjëra të tjera jo. Fredi-ndriçimin..Maksi-atje ku nuk ka ndriçim, ndriçimi nuk paguhet për familjet në çdo lloj lagje, në çdo lloj rrugice e të tëra me radhë..Fredi-e kam me fatura, e kam me fakte konkrete por nuk dua të penalizohen..Maksi-jam dakort me ty, aty tek Kurtajt përshembull, po ne kemi filluar ndriçimin dhe këtë vit e kemi përmirësuar edhe ndriçimin me fotovoltai, me këto rrezet diellore që ka filluar të ndryshohet dhe të vendoset në disa vende..Fredi-absolutisht, a është shkelje ligjore thashë apo jo, tarifa paguhet.. Maksi-po të jetë shkelje ligjore ka një gjykatë që e vërteton..Fredi-problemi është a është shkelje duhet të më thuash sepse tarifa paguhet, tarifa në qoftë se spaguhet dhe vilet është vjedhje, tarifa paguhet në qoftë se shërbehet se nuk është taksë, tjetër gjë taksa e tokës, taksa e tokës e punon se punon është tjetër gjë, je i detyruar ta paguash. Tarifa në qoftë se nuk shërbehet është vjedhje, dhe vilet është vjellje. Maksi- varet sesi interpretohet vjedhja apo mbledhja e tarifës, tarifa për ndriçim, për.. Fredi-mbase nuk gjeta një fjalë më të bukur unë, po më fal po..Maksi-dhe unë po them varet sesi interpretohet, duam ne sduam ne për arsye se ndriçimi, gjelbërimi apo qoftë edhe lulishtet që paguhet e të tëra me radhë, janë tarifa që paguajnë të gjithë si fshat, nuk paguhet vetëm atje ku është lulishtja kryesore e fshatit, apo ndriçimi janë rrugët kryesore nga qendra deri në një farë vendi. Ne për të përmirësuar ndriçimin të paktën po flasim se për mbeturinat ne jemi futur në çdo vend pak a shumë për ti mbledhur, ndërsa për ndriçimin ka disa difekte të vogla që kemi menduar dhe me miratimin tuaj, kemi blerë vazhdimisht ndriçues diellor me qëllim që të bëjmë ndriçimin dhe në ato vende që janë të vështira për tu kaluar, përshembull nëpër ura, nëpër kthesa të forta. I kemi vendosur pjesën më të madhe të tyre, jemi përpara sot që flasim bashkë kemi edhe 100 copë për ti vendosur, po bëjmë studim të hollësishëm dhe me Kryetarët e fshatrave për ti vendosur edhe këto, me qëllim që të kemi një ndriçim sa më.. që të quhet tarifë e paguar. Pyetja tjetër përjashtohet nga taksa e tokës 30%-çi problemi i thatësirës, por unë do të thoja edhe të përmbytjeve që kemi sot në lumin Seman, pra jemi para një fakti të tillë që ky 30% duhet të ketë një indicio, që të vijmë në Këshillin e Bashkisë duhet të ketë një indicio nga fermerët apo nga biznesmen e të tjera me radhë ku janë ato fatkeqësitë natyrore, siç do kemi tani në lumin Seman që ka dalë nga shtrati, ndërsa ska dalë nga argjinatura akoma që flasim sot, se dhe sot jemi në pika kritike të argjinaturës, për ato që janë të mbjella në pjesën e argjinaturës kuptohet, kemi ngritur komisionin e verifikimit të dëmeve dhe ky komision do të dali me një konkluzion për të ardhur përpara Këshillit, për të thënë pastaj se kujt i duhet falur, se ulla dihet që njëherë shton bën e njëherë sben dhe po qe se çdo vit ne themi kur sben prodhim do falim 30% të taksave, sikur nuk vemi dot në krye të kë.aj pune për mbledhjen e taksave. Për Odën e Fermerëve unë nuk të jap dot përgjigje, ta them sinqerisht se nuk jam i përgatitur, nuk e di Selmani ka ndonjë, se është miratuar këtu në Këshill për ata që ishin në Odën e Fermerëve për të

falur taksat, unë nuk të genjejë dot tani. Selmani-ai vendim aktualisht është në fuqi. Kryetari-tjetër kush e kërkon fjalën për pyetje? Për diskutim sa i takon paketës fiskale? Fredi-për diskutim kisha. Siç e thashë edhe gjatë pyetjeve është se vjelja e tarifës nuk është ligjore, vetëm z.Nënkryetar nuk e tha, po nuk është ligjore dhe është vjedhje. Fjalë mbase më të bukur nuk gjejë, dhe nuk duhet mbledhur tarifa pavarisisht.. Maksi-të lutem të mos keqkuptohemi se unë nuk thashë që është vjedhje. Fredi-sepse derisa nuk është ligjore vjelja e tarifës, nuk është ligjore është vjedhje. Vjedhje është sepse ti kapësh kokën me derë atij biznesi..Maksi-o Fredi të lutem tani, kemi bërë debate bashkë dhe unë jam këtu, jam përballë teje sy më sy, shikojë dhe di të komunikojë, me fjalët që interpretojë unë nuk ke të drejtë ti shtrembërosh, unë nuk thashë është vjedhje..Fred-i jo e thashë unë. Dëgjo në qoftë se një tarifë nuk shërbehet dhe e kap kokën me derë një biznesi këtu dhe ja merr atë tarifën, atëherë është vjedhje për mendimin tim. E dyta, ajo falja e taksave, tarifave Odës së Fermerëve unë kujtova sepse u mor një vendim në një moment të caktuar, për të justifikuar ca firma, për të hapur një fabrikë, nuk e di ëndërra e Kryetares që ka kohë por akoma nuk është bërë realitet, dhe thashë se u këputë dhe kujtoja se kishte nevojë për..po përderisa se kishit te përjashtuesit e taksave dhe tarifave, duhet ta kishit paraqitur aty kush janë përjashtuar këtu, është dhe me hile këtu. Në qoftë se ju vazhdoni sepse unë kam, jo kam fakte po aty ka anëtar të Odës së Fermerëve që bëjnë miliona euro xhiro vjetore dhe përjashtohen nga një taksë minimale. Në qoftë se ju vazhdoni kështu, unë do bëj thirrje të gjithë fermerëve të bëhen anëtar të Odës së Fermerëve dhe mos të paguajnë taksën, se kjo është selektive, është korruptive. Unë kam fakte për shumë njerëz që kanë biznese miliona eurosh dhe nuk flas kot, e përmend edhe këtu por nuk dua sepse është gjë e ulët ta përmend unë, se ju i dini vet, i keni venë vet me qëllim. A keni menduar, unë bëra një pyetje a keni menduar për uljen e taksës së tokës sepse thatësira e tejzgjatur të gjithë e keni parë vet, ulliri është 20% e prodhimit vetëm nga arsyet janë thatësira e tejzgjatur, edhe përmbytjet por sishin këto përmbytjet, te përmbytjet mbas përmbytjeve bëhet evidentimi i dëmeve dhe pastaj absolutisht, atë të shkretët kanë pasur dëme të mëdhaja, të përjashtohen nga taksa automatikisht se ska arsye, po në përgjithësi sepse e kupton ne skemi as sistem vaditje, dhe kënetat dhe rezervuari nuk kanë funksionuar sivjet dhe unë prandaj e bëra, që kur ju studioni për 5 vite, për 10 vite deri në vitet 50 me 200 faqe për fatkeqësi natyrore, mund të propozoni për këtë vit të paktën uljen e një shifre, ça të donit ju të paktën, po edhe sado e vogël të ishte, për këtë e bëra. Unë kam dhe propozime : ulja e taksës së tokës me 30%, siç e kemi deri në Qershor ta ulim për të gjithë fermerët, të paktën për këtë vit 30% për të gjithë fermerët, siç e kemi deri në 30 Qershor, ta ulim deri në fund të vitit. Kam një propozim tjetër ulja 30% e taksës së prapambetur, taksa dhe tarifa ça kanë ndër vite. Propozojë që siç e kemi për taksën vjetore deri në 30 Qershor, të bëhet deri në 30 Qershor, të bëjmë thirrje, të bëjmë njoftime nëpër fshatra, mbase dhe në televizione, në rrjetet sociale që ata që kanë të prapambetura ndër vite, deri në 30 Qershor tja falim 30%, mbase ndikon që të vilet sepse hallexhinjë janë edhe ata, nuk është se e kanë, ata e dinë që nuk falet taksa por në vazhden dhe të Kryeministrit se dhe ai po fal edhe në dogana, edhe ca gjoba të prapambetura, që ato janë biznese që po falen, unë po them këta janë hallexhinjë, po merren me tokën, me ullishtet, i kanë duart thela-thela, ta merrnim dhe këtë radhë një vendim. Dhe në vendimin këtë radhë që marrim për taksat dhe tarifat të cilësohet propozojë të cilësohet, se në një mbledhje të caktuar nuk e mbaj mend mbledhjen si ka qënë, nuk e di se kush qe nga anëtarët e Bashkisë Kryetarja apo Nënkryetari, e cilësoi duhet ta kishit vënë ju, ta cilësonit në vendimin e Këshillit që përjashtohen nga tarifatat atje ku nuk shërbehet, dhe meqë është e nevojshme unë propozojë që të cilësohet tarifa atje ku nuk shërbehet mos të vilet, këto ishin propozimet e mia. Kryetari-faleminderit z.Fredi,

dikush tjetër? Në emër të grupit z.Elmaz kishit gjë në lidhje me pake an fiskale? Elmazi-jo skam. Kryetari-atëherë sa i takon propozimeve ? Selmani-sa i takon propozimeve unë do të thoja që ulja e taksës minus 30% deri në Qershor ka qënë në formën e një stimuli, sepse çdo të thotë në qoftë se këtë minus 30% ne e bëjmë për tërë vitin? Se di tani nuk quhet stimul pastaj, do të thotë ulje drastike dhe të të ardhurave, ndërhyrje në buxhet dhe unë them që e humbet atë të stimulit që mund ti kryhet njerëzve, bashkohen të dy bashkë si ai që i ka paguar dhe ai që nuk e ka paguar fare, sepse propozon që deri në 30 Qershor të ulen edhe ato të prapambeturat. Unë mendoj që mos ti ndërhyjmë këtyre gjërave sepse ulja minus 30% të atyre të prapambeturave do na hapi punë me këta të tjerët dhe në vend që ata të derdhnin atë 70% që propozon ti për vitin 2026, nuk do e derdhnin fare se do thonë që edhe mot në vitin 2027 po të njëjtën gjë do bëjnë atje dhe lëre se do na ulet, skam sivjet i derdh në 2027. Unë them që këto ulje dhe periudha që ne vendosim atje është në formën e stimulit dhe e humbet, dhe është pastaj ulje drastike e këtyre taksave dhe si pasojë dhe e të ardhurave të Bashkisë, do kërkojë dhe ndërhyrje në buxhet pastaj. Fredi-po mirë stimul është dhe ky, deri në 30 Qershor kush ka të prapambetura stimul është dhe ky. Unë prandaj të pyeta ke një shifër sa është 70,80 milion ndër vite, ne e stimulojmë deri në 30 Qershor të prapambeturat, e stimulojmë që të paktën të mbledhim, të jesh i bindur ti që do mbledhim ca. Maksi-po ky 80%-çi që i paguan çfarë do të bëj pastaj? Do presi këta? Kryetari-kjo stimulon pjesën e atyre që kanë paguar që mos të paguajnë, po i stimulojmë që të mos paguajnë. Fredi-po si mos të paguajnë, ne nuk po falim..Kryetari-atëherë unë po them po rri 3 vjet pa i paguar, i administrojë vet dhe presë kur ti ulësh ti prapë. Janë përvoja që janë bërë në disa institucione. Fredi-ore edhe ne e kemi bërë, ça përvoja nuk e di, ne e kemi bërë këtë, edhe kur ka qënë Kryetarja herën e parë e kemi bërë, është ligjore, është dhe morale, ashtu u vijmë në ndihmë, edhe stimul. Në qoftë se doni ta kaloni, unë them të bëhemi edhe ne pjesë e vendimmarrjes. Kryetari-dakort, ky ishte propozimi juaj, nuk është se jemi dakort dhe propozimi tjetër unë do doja që për saktësimin që kërkoj z.Fredi..Selmani-që mos të mbahet tarifë atje ku nuk shërbehet. Kryetari-po. Selmani-po është, nuk ka nevojë. Fredi-jo, po të hapim vidion ne këtu, një person këtu është thënë që në një moment të caktuar është thënë po ju se keni përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak, po s'që në procesverbalet aty që ka mbajtur znj.Sekretare, nuk e keni përcaktuar kur keni miratuar paketën fiskale, dhe unë propozojë kur është pse mos të çojmë dhe këto dy fjalë që them unë, pse ça problemi ka? Selmani-paketa fiskale nuk i përcakton këto, këto përcaktimet nuk merren në Paketë Fiskale kur nuk i shërbehet, unë them që është jashtë asaj. Fredi-po kur unë kam faturat këtu që i keni faturuar, keni vjelë tarifën kur nuk ka ndriçim, atëherë në qoftë se vihet këtu ju nuk keni mundësi që ta vilni, ja për këtë e kërkojë unë dhe ti e di shumë mirë që ne..unë e kërkojë sepse deri sa nuk ka pasur atëherë pse ta vendosim ça dëmi ka? Si nuk përcaktohet këtu, përcaktohet që çke me të. Maksi-si do ti ndajmë deri ku vete ndriçimi i rrezes së dritës? Fredi-përshembull një biznes, unë e kam marr dhe me shembuj këtu por pse ti mbaj ti përgojë ata se gjynah. Ndriçimi tek lokali i Fredi Feleqit këtu nuk ka ndriçim, ai nuk duhet të paguaj, për biznesin X ai paguan ndriçim dhe nuk ka. Maksi-nga njëri vit në tjetrin e kupton shumë mirë që është përmirësuar ndriçimi me sipërfaqe e të tjera me radhë. Fredi-se diskutojë fare atë unë..Maksi-po pse është përmirësuar, se po të paguajnë vetëm këta që kanë ndriçim, ne nuk kemi të drejtë të mbledhim lekë për të vazhduar ndriçimin më tej. Fredi-po funksionojë ashtu sepse ne do paguajmë të gjithë dhe do ndriçojmë 5 veta, nuk funksionon ashtu tarifa..Maksi-nuk po selektojmë, të thashë edhe njëherë ne kemi gjetur përmirësimin me fotovoltaike dhe do vazhdojmë. Fredi-absolutisht jam dakort. Maksi-dhe pastrimi deri dje ne kishim 15 kosha, figurativisht 15 kosha, sot kemi 1500 kosha që i kemi vetëm për Roskovecin, kemi

mbledhur këto të ardhura pa kemi blerë kosha. Fredi-po mirë shumë mirë, skemi pasur këto taksa dhe tarifa ne, i kemi rritur taksat dhe tarifat ne, unë të them mos tja marrësh, mos ti biesh në qafë X ose Y..Maksi-ore do e përmirësojmë nesër ne..Fred-si do ta përmirësosh, ti sja ke dhënë more, pse do tja marrësh lekët? Maksi-nga njëri vit në tjetrin e thashë edhe njëherë shtohen sipërfaqet e gjelbëruara, shtohet dhe numri i koshave, shtohet ndriçimi..Fred-atëherë kur tja çosh merre dhe atë, kur tja çosh ti ndriçimin..Maksi-po si tja çoj ndriçimin po nuk mblodha të ardhura unë? Fredi-po si do tja çosh ti ndriçimin me të vjelur, ka 10 vjet, 20 vjet që paguan pa ligj në kundërshtim, po 20 vjet do tja çosh ti dhe akoma sja ke çuar. Maksi-unë po them është përmirësuar..Fred-dhe unë jam koshient që është ndryshuar absolutisht por unë po të them në qoftë se ti ja ke vjelë 20 vjet padrejtësisht me këtë arsye, me këtë justifikim do tja vjelesh pa fund. Maksi-tani është e drejta juaj të bëni propozime, të bëni dhe vërejtje për paketën fiskale, po ne po vijmë para jush dhe themi që nuk ka ndryshime nga njëra paketë në tjetrën, prapë vijmë me një llogjikë të përcaktuar mirë dhe të menduar mirë. E dyta, po qe se ne fillojmë ulim me propozimin tuaj sot, siç tha dhe Selmani në qoftë se ne sot vijmë për të ulur një të ardhur vendore, duhet të rishikojmë edhe njëherë dhe projekt-buxhetin të cilin jemi gati duke e nisur. Në qoftë se në të ardhurat vendore janë 40% apo 50% e gjithë buxhetit, me këtë 30%-çin ne do të ulim 10% të paktën të gjithë buxhetit të vitit të ardhshëm. Elmazi-duke dëgjuar dhe duke parë materialet, them se në paketën fiskale duke e shikuar me vëmendje, ishim plotësisht dakort si grup që ta kalojmë në Këshill.Problemet të cilat lindin gjatë rrugës, gjatë mendimeve të njërit dhe tjetrit, unë do i shtrojë një pyetje atij, pa i zënë emrin në gojë shokut, zotrisë. Unë që i kam paguar ato të ardhura, ku do të mbështetem? Dhe në qoftë se unë do të shikojë një vendim të Këshillit Bashkiak që atyre do tua ulin 30%, dhe unë si paguaj pastaj. Unë i kam paguar 140 mijë lekë prandaj mendoj si individ që të vendoset si të jetë më e mira për ata të cilët ne na kanë prurë këtu në atë karrige, por nuk është e drejtë që ne të ulim 30%-çin këtyre që skanë paguar, që në vend që të kërkojmë taksat, të gjejmë rrugët e mundëshme për ti ndihmuar ata, për ti lehtësuar ata në punën tonë aparati i Bashkisë, që ata të binden se nuk ka shërbim po nuk pagove, nuk ka shërbim, është leku ai që të shërben në çdo skaj. E dyta, tek ato pagesat të cilat ngrihen, ndonëse mund të ketë ndonjë farë të drejte, ne dhe këtu në Këshill unë e kam trajtuar si problem. Nuk kemi të drejtë ti marrim atij fshatari që ne nuk i shërbejmë, ose asaj rruge që ne nuk i shërbejmë, jo jo dhe unë jam dakort, përderisa ti nuk më shërben, pse ma merr? Por atje ku shërbehet do merret sepse me ato të ardhurat të cilat ne marrim, në bazë të asaj popullsie që ne mbulojmë unë them i shërbejmë qytetarëve, prandaj unë mendoj që ta hedhësh në votë dhe i lutem të gjithëve që ta kalojmë këtë paketë fiskale. Kryetari-faleminderit z.Elmaz, duke parë dhe rëndësinë dhe hapjen e rrugës së miratimit më vonë të projekt-buxhetit, ju ftoj të gjithëve të votoni projekt-vendimin "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026", me dy saktësimet e kërkuara nga këshilltari z.Fredi Feleqi, me saktësimet si më poshtë: tarifa e gjelbërimit në fshat do ti tarifohet vetëm familjeve që përfitojnë nga ky shërbim, pra vetëm në ato zona ku ka hapsira të gjelbëruara, të vërtetuara nga Ndërmarrja e Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes së Varrezave. Njëkohësisht tarifa e ndriçimit në fshat do ti tarifohet vetëm familjeve që përfitojnë nga ky shërbim, pra vetëm në ato zona ku ka hapsira të ndriçuara..Fred-familje dhe biznes. Kryetari-familje dhe biznese, të ndriçuara të vërtetuara nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes. Jemi korrekt z.Fredi? Atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026"..Fred-me këto propozime që bëra unë? Kryetari-po pra këto që lexova, jo 30%-çin. Fredi-më fal po pati mundësi, mirë të hiqet 30%-çi, po të çohet 30%-çi deri në Qershor për paratë e prapambetura..Kryetari-dakort pra e morëm propozimin..Fred-jo mirë

për gjithë vitin, por të prapambeturat sepse i bie që z.këshilltar z.Elmaz meqë më paragjykoj..Elmazi-të lutem, nuk të paragjykojë unë..Kryetari-për procedurë a mund ta kalojmë në parim dhe pastaj hedhim në votim propozimin tuaj? Fredi-si ta hedhim? Kryetari-votojmë në parim projekt-vendimin për miratimin e paketës fiskale dhe propozimin tuaj do ta hedhim në votë sepse nuk mundim..Fred-propozimi ashtu hidhet ajo e gjithë, ne na bëni pjesë të votimit, na bëni pjesë dhe të paketës..Kryetari-po pjesë pra, tani e mora parasysh..Fred-tani si mund ta hedhim ne po përjashtuam këto, ju thatë megjithë propozimin tuaj..Kryetari-propozimi juaj që unë lexova, ato që citova. Maksi-ato që citoi Kryetari i Këshillit, që tha atje ku nuk shërbehet..Kryetari-atje ku nuk shërbehet nuk ka pse të tarifohet. Fredi-po hidhe dhe këtë tjetrën. Maksi-po tani nuk hidhet kjo tjetra, ajo..Elmazi-do ma kthesh mua 30%-çin ti që kam paguar? Fredi-ti ske paguar, 30% minus ke paguar, dhe ai ne po i ofrojmë të paguaj sa ke paguar ti, absolutisht. Maksi-sot jemi në 27 Nëntor, o z.këshilltar propozimi yt thua deri në 30 Qershor, ai që ka paguar në 1 Korrik ça ti bëjmë ne? Ai që i ka paguar taksat në 1 Korrik, që i ka paguar 100%, ça ti bëjmë ne? Fredi-po edhe ai do ti paguaj, dhe ata të prapambeturit në qoftë se nuk i paguajnë deri në 30 Qershor, ashtu do ti paguajnë prapë 100%..Maksi-unë them 80%-çi i ka paguar në 1 Korrik, në 25 Korrik, 30 Gusht..Fred-unë po propozojë të stimulohen edhe ata të prapambeturit siç po stimulohen këta të këtij viti. Maksi-e drejta jote të propozosh por jo të..Fredi-po nuk vendos unë, unë po them propozim, si do ta vendos unë? Maksi-kaloni në parim propozimin për ti hapur rrugë buxhetit, kaloje..Fred-unë spo them ta kalojë, edhe propozojmë edhe mbështesim nuk është e njëjta gjë. Se ku do gjenden lekët ta tregojë unë se ku do gjenden lekët për buxhetin, sepse kur ka ardhur znj.Kryetare këtu e ka gjetur Bashkinë me 259 punonjës dhe e ka bërë me 300, 400 e ca punonjës. Lëre tani mos të bëjmë lojra fjalësh..Elmazi-është muhabet tjetër ky Feleq. Fredi-nuk kërkon asnjë gjë kjo që po them unë, është stimul. Kryetari-kush është dakort ta miratojmë në parim projekt-vendimin “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2026”? Kryetari hedh në votim projekt-vendimin në parim dhe me 10 vota pro, 2 vota kundër F.Feleqi, A.Pelo nuk miratohet ky projekt-vendim. Kryetari-faleminderit të gjithë këshilltarëve për votimin.

#### 8.Për miratimin e procedurës së binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec Shqipëri dhe Komunës së Ururit Itali.

Kryetari-presim pak çaste sa të vij specialistja e cila do të bëj një prezantim.Sp.Integritet Europian Ulpjana-të nderuar këshilltar, ju paraqes për miratim procedurën e binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec dhe Komunës së Ururit në Itali. Sqaron bazën ligjore sipas materjalit të paraqitur. Paraprakisht për këtë procedurë janë zhvilluar dy takime. Së pari është zhvilluar takimi në Bashkinë Roskovec në 30 Korrik të këtij viti, dhe më pas në Tetor është zhvilluar takimi tjetër në Komunën e Ururit. Fokusi i këtyre takimeve normalisht ka qënë shkëmbimi i ideve dhe eksplorimit të fushave të ndryshme si kultura, arsimit, arti dhe turizmi si dhe fusha të tjera. Bazuar në kërkesën për nisjen e procedurave të binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec dhe Komunës së Ururit në Itali, normalisht palët kanë konfirmuar interesin e tyre të ndërsjelltë, për krijimin e një partneriteti institucional dhe si vijim i kësaj procedure standarte, do të vijojë fillimisht me hartimin dhe miratimin nga Këshilli Bashkiak i procedurës së bashkëpunimit, normalisht që është dita sot. Më pas marrjen e mendimit të Ministrisë së Europës dhe Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më pas negociimi dhe dakortësimi i një memorandumit bashkëpunimi, më pas është firmosja e marrëveshjes së binjakëzimit midis Kryetares së Bashkisë tonë dhe homologes së Komunës së Ururit, dhe më

pas hartimi i një plani të përbashkët të aktiviteteve për zbatimin e kësaj marrveshje. Normalisht arsytet e binjakëzimit janë nxitja e shkëmbimeve kulturore dhe sociale midis Bashkisë tonë dhe Bashkisë së Ururit, promovimi i traditave, vlerave historike dhe identitetit lokal arbëresh, duke qënë se Komuna e Ururit është një Komunë Arbëreshe. Krijimin e mundësive për projekte të përbashkëta në fushat si kultura, arsimi, rinia, bujqësia dhe zhvillimi ekonomik, si dhe forcimi i marrdhënieve midis komuniteteve duke përfshirë komunitetin shqiptar në Itali. Qëllimi i binjakëzimit midis dy bashkive është forcimi i marrdhënieve miqësore, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira, promovimi i kulturës dhe trashëgimisë, zhvillimi ekonomik-turistik, bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe të rinisë, forcimi i lidhjeve me diasporën, zhvillimi i projekteve të përbashkëta përmesë implementimit të projekteve të ndryshme të financuara nga Bashkimi European, nxitja e solidaritetit dhe bashkëpunimit humanitar, normalisht në rastin e emergjencave që mund të kenë të dyja vendet. Për formalizimin e këtij bashkëpunimi është e nevojshme miratimi i procedurës së binjakëzimit në Këshillin Bashkiak, si dhe miratimi i këtij projekt-vendimi i hap rrugën ose krijimin e bazës institucionale dhe ligjore midis dy komuniteteve. Ju faleminderit. Nuk e di nëse keni pyetje? Kryetari-atëherë pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim? Leksi-ishin të qarta të gjitha. Kryetari-për diskutim e kërkon dikush fjalën? Nuk ka. Kryetari-atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për miratimin e procedurës së binjakëzimit midis Bashkisë Roskovec Shqipëri dhe Komunës së Ururit Itali”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro. Kryetari-me të gjitha votat pro miratohet ky projekt-vendim, faleminderit për votimin.

#### 9.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari-nuk e di qytetari që kemi nuk është se është regjistruar për diskutim? Sekretarja-jo, nuk është regjistruar për diskutim. Kryetari-atëherë të nderuar këshilltar, për diskutime jashtë këtij rendi dite kërkon dikush nga ju fjalën? Në mungesë të kësaj kërkesë..Fredri-jo kisha diçka meqënëse është dhe z.Maksi këtu. Ai rezervuari i Ngjeqarit është shtuar rrjellja tek diga, kam vajtur dje sepse është mbushur, ka vajtur në pikën që..Maksi-pas takimit tonë të përbashkët, ne kemi shkuar me grup pune, megjithatë prapë nesër, sot..Fredri-jo nuk është halli sot për nesër, gjeni një zgjidhje të paktën, mbase duhen gjëra minimale për momentin sepse sa vjen dhe shtohet, dhe është bërë gjithë ajo punë..Maksi-e di që kanë vajtur dhe një grup inxhinierësh për ta parë, pas takimit tonë të përbashkët. Fredri-nejse ska gjë jo, e thashë se mos harroj. Vajta dje sepse tani ka ardhur në kohën e mbushjes plotë ajo dhe te dalja rrjellë dhe kam hall mos të pëllicasë diga, mbase dhe nuk pëlletet por ne marrim masat për gjëra të vogla. Kryetari-faleminderit,po vazhdojmë me kthim përgjigjet mbi problematikat e ngritura në mbledhjen e Këshillit në datën 30.10.2025. Ju lutem vetëm pak durim, do përpiqem që të jem i shpejtë në leximin e kthim përgjigjeve. Në përgjigje të kërkesës së ardhur nga Këshilli Bashkiak Roskovec me Nr.9274 protokollit, i datës 05.11.2025 në lidhje me problematikat e ngritura gjatë mbledhjes së Këshillit, informacioni vijon si më poshtë: Kërkesat dhe ankesat të cilat janë ngritur në mbledhjen e Këshillit, u janë deleguar drejtorive përkatëse, për shqyrtim dhe ndjekje të tyre deri në zgjidhje. Sipas pikave më poshtë po ju njohim me praktikën e ndjekur. Kryetari lexon përgjigjet e kthyera nga administrata sipas kësaj shkrese. Në lidhje me problemin e mungesës së ujit në fshatin Ngjeqar, ku kërkohet që drejtoria përkatëse në Bashki, ti dërgojë një shkresë zyrtare Ministrisë përkatëse dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizime, për të parë me përparësi gjetjen e një zgjidhje për

furnizimin me ujë të fshatit Ngjeqar pasi situata është emergjente, nga këshilltari z.Fredi Feleqi. Kthim përgjigje-bashkëlidhur kërkesën emergjente për çpim pusi për fshatin Ngjeqar që Bashkia Roskovec i ka drejtuar Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Fier. Bashkëlidhur kësaj kthim përgjigje është edhe kërkesa zyrtare që i është drejtuar shoqërisë së Ujësjellës-Kanalizime. Pika dy ose kërkesa e dytë, në lidhje me kërkesën e fermerëve për të ndërhyrë në rrugën që ndodhet anës kanalit, që vjen nga Vidhishta dhe del në kolektor, rruga fillon tek kryqëzimi i Marinzës. Kthimi i përgjigjes nga administrata në lidhje me këtë kërkesë ku kërkohet ndërhyrje anës kanalit nga Kumani dhe del në kolektor, bëjnë me dije se është kryer verifikimi nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Rural dhe Mirëmbajtjes dhe rezultoi se nga ana e perëndimore e përroit, përveçse përdoret si rrugë parcele, është dhe hapsirë për hedhjen e dheut nga pastrimi i përroit dhe për këtë arsye nuk mund të trajtohet me çakull. Kërkohet një informacion në mbledhjen e radhës sesa është investuar për sigurinë e rezervuarit të Kurjanit, nga z.Jorgo Begaj ishte kërkesa. Sa i takon kërkesës së ngritur nga ana e këshilltarit më datë 30.10.2025 mbi projektin "Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësive ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit" bëjnë me dije se ky projekt është fituar nga ana e Bashkisë Roskovec nëpërmjetë programit "Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes" pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku përqindja e realizimeve të punimeve të arritura deri më sot kap vlerën 85% të vlerës së projektit. Problemi i ujit në shkollën e fshatit Ngjeqar, pompa e ujit nuk ka fuqi të furnizojë me ujë katin e dytë të shkollës. Është ngritur ky problem nga këshilltari z.Nazmi Zeka. Kthim përgjigje në lidhje me problematikën në shkollën "Sabri Refiti" Ngjeqar mbi furnizimin me ujë, bëjnë me dije nga verifikimet e kryera nga Drejtoria e Mirëmbajtjes dhe Investimeve, pusi i cili furnizon shkollën me ujë është në nivel të ulët dhe për këtë arsye furnizohet vetëm kati i parë i shkollës. Kryetari-këto janë përgjigjet. Nuk e di sa i kënaqin pritshmëritë tuaja si përgjigje, gjithsesi secili nga ju i cili dëshiron që të ketë një kopje të kthim përgjigjeve nga administrata, mund ti tërheqi pas mbylljes së kësaj mbledhje. Duke ju falenderuar edhe njëherë për pjesmarrjen, e deklarojë këtë mbledhje të Këshillit të Bashkisë të mbyllur. Faleminderit dhe gëzuar festat.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**



**Kryetar**

**Afrim Plaka**

